

20251984012

Në bazë të nenit 81 të Ligjit të Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhunës në Familje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 24/21 dhe 39/25), Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, miratoi

**RREGULLORE PËR METODËN E ZBATIMIT DHE METODËN E MONITORIMIT
TË MASAVE TË PËRKOHSHME TË SHQIPTUARA TË MBROJTJES**

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e zbatimit dhe mënyra e monitorimit të masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes nga Qendra për Punë Sociale (në tekstin e mëtejme: qendra).

Neni 2

Zbatimi dhe monitorimi i masave të përkohshme të shqiptuara për mbrojtjen e grave viktime të dhunës me bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje (në tekstin e mëtejme: viktimat), nga profesionistët e Qendrës, kryhet urgjentisht, me vëmendje të duhur për realizimin e të drejtave dhe nevojave të viktimës, me qëllim parandalimin e dhunës në të ardhmen.

Neni 3

Masat e përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes zbatohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve, me ekzekutimin e tyre dhe me ndërmarrjen e veprimeve për realizimin e masës/masave, në përputhje me ligjin.

Neni 4

Monitorimi i zbatimit të masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes nga profesionisti, i cili e drejton rastin në Qendër (në tekstin e mëtejme: profesionisti), realizohet përmes komunikimit dhe koordinimit të vazhdueshëm, shkëmbimit të rregullt të informacionit me institucionet dhe organet që i ekzekutojnë masat e përkohshme të shqiptuara, komunikimit të drejtpërdrejtë me viktimat, shoqatat, raportimeve nga qytetarët për sjelljen e autorit të veprës penale në shkelje të masës së përkohshme të mbrojtjes dhe ndërmarrjen e veprimeve, në bazë të të cilave mund të përcaktohet nëse është arritur qëllimi i masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes.

Profesionisti i dorëzon kërkesë institucionit dhe organit, i cili e zbaton masën e përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes për marrje të informacioneve të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 5

Profesionisti regjistron çdo veprim të ndërmarrë gjatë monitorimit të masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes.

Neni 6

Profesionisti e mban dhe e përgatit dokumentacionin zyrtar për monitorimin e zbatimit të masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes, si në vijim: plani individual për siguri të viktimës dhe lista e përfituesit.

Neni 7

Profesionisti duhet ta informojë gjykatën për efektin e kryerjes së masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes, bazuar në njohuritë e marra nga monitorimi i zbatimit të masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes dhe dokumentacionin zyrtar të përgatitur.

Neni 8

Në bazë të në monitorimit të zbatimit të masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes, dhe në përputhje me vlerësimin e efektit të zbatimit të masës/masave nga qendra, me pëlqimin e viktimës, gjykatës i dorëzohet një propozim për zgjatjen, zëvendësimin ose ndërprerjen e masës/masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes dhe për ndërmarrjen e veprimeve në përputhje me ligjin.

Neni 9

Profesionisti e monitoron zbatimin e masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes, si vijon: ndalimin e kryerësit të dhunës në familje nga kërcënimi për të kryer dhunë, ndalimin e maltretimit, të ngacmimit, të telefonimit, të kontaktimit ose të komunikimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me viktimën, ndalimin për t'u afruar brenda 100 metrave nga banesa, shkolla, vendi i punës i viktimës ose i një vendi specifik, të cilin e frekuenton rregullisht, largim nga shtëpia pavarësisht pronësisë për një periudhë prej të paktën dhjetë metrash, e një maksimum prej 30 ditësh, si dhe ndalim për posedimin e armëve të zjarrit ose armëve të tjera ose konfiskimin e tyre, të cilat kryhen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Profesionisti, gjatë zbatimit të masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes nga paragrafi 1 i këtij neni, kërkon njoftim nga njësia organizative kompetente për çështjet penale për zbatimin e masave dhe të aktiviteteve për mbrojtjen e sigurisë së viktimës dhe të anëtarëve të familjes së saj ose për ta parandaluar përsëritjen e dhunës, të paktën çdo tre muaj.

Profesionisti, gjatë monitorimit të zbatimit të masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes, shqyrton dhe vepron sipas njoftimit të nëpunësit të policisë nga njësia organizative kompetente për çështjet penale (në tekstin e mëtejshëm: nëpunësi i policisë), për ecurinë e kryerjes së masës.

Profesionisti, gjatë monitorimit të zbatimit të masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes, shqyrton dhe vepron sipas njoftimit të nëpunësit të policisë nga njësia organizative kompetente për çështjet penale (në tekstin e mëtejshëm: nëpunësi i policisë), për ecurinë e kryerjes së masës.

Qendra, gjatë përgatitjes së propozimit për zgjatjen, zëvendësimin ose ndërprerjen e masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes dhe ndërmarrjes së veprimeve të tjera në përputhje me ligjin, merr parasysh njoftimin nga nëpunësi i policisë për efektin e zbatimit të masës së përkohshme të mbrojtjes, ndryshimet thelbësore në mjedisin e viktimës ose në mjedisin e kryerësit të krimi, të cilat mund të ndikojnë në sigurinë dhe në mbrojtjen e viktimës ose në përsëritjen e dhunës.

Neni 10

Profesionisti, gjatë monitorimit të masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes, përkatësisht: kryerësi duhet t'i kthejë sendet e nevojshme për t'i përmbushur nevojat e përditshme të viktimës dhe të familjes, mirëmbajtje e detyrueshme ligjore për familjen dhe kryerësin e dhunës kërkohet për t'i kompensuar shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara si pasojë e dhunës, viktimat kontaktohet lidhur me mënyrën dhe efektet e kryerjes së këtyre masave.

Me marrjen e njoftimit nga viktimat për mosrespektimin ose shkeljen e masave të përkohshme të shqiptuara të mbrojtjes, Qendra menjëherë, dhe jo më vonë se tre ditë nga dita e marrjes së njoftimit, e njofton gjykatën.

Neni 11

Profesionisti merr informacion lidhur me mënyrën dhe efektet e ekzekutimit të masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes vizitën e detyrueshme të kryerësit në qendrën e këshillimit, nga ofruesi i shërbimit, i cili e ekzekuton masën e përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes.

Nga ofruesi i shërbimit - këshillimorja, e cila e zbaton trajtimin psiko-social për ekzekutimin e masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes, frekuentimin e detyrueshëm në këshillimore kryerësit e dhunës ndaj grave ose dhunës në familje, qendra kompetente që monitoron masën e përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes informohet të paktën një herë në muaj për rrjedhën e trajtimit psiko-social, dhe pas përfundimit të trajtimit, qendrës kompetente i dorëzohet raport për efektin e trajtimit dhe ndryshimin e sjelljes së kryerësit.

Në rast se kryerësi i dhunës nuk e raporton ose e ndërpret trajtimin psiko-social, ofruesi i shërbimit duhet menjëherë, dhe jo më vonë se tre ditë nga dita e marrjes së informacionit, ta njoftojë qendrën dhe të dorëzojë raport mbi arsyet e ndërprerjes së trajtimit.

Pas marrjes së njoftimit të paragrafit 3 të këtij neni, qendra duhet menjëherë, dhe jo më vonë se tre ditë nga data e marrjes së njoftimit, ta njoftojë gjykatën për çdo mosrespektim ose shkelje të masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes.

Neni 12

Profesionisti, lidhur me mënyrën dhe efektet e ekzekutimit të masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes së mjekimit të kryerësit, nëse ai përdor alkool, drogë dhe substanca të tjera psikotrope ose ka sëmundje mendore, merr informacion nga institucioni shëndetësor që e ekzekuton këtë masë.

Institucioni shëndetësor duhet t'i dorëzojë qendrës kompetente që monitoron masën e përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes të mjekimit të detyrueshëm të kryerësit menjëherë, dhe jo më vonë se tre ditë pas përfundimit të trajtimit, si dhe çdo tre muaj gjatë mjekimit, raport mbi efektin e mjekimit të kryerësit.

Në rast se kryerësi nuk paraqitet ose e ndërpret mjekimin e detyrueshëm, institucioni i kujdesit shëndetësor duhet menjëherë, dhe jo më vonë se tre ditë pas marrjes së informacionit, ta njoftojë qendrën kompetente.

Qendra, me marrjen e njoftimit të paragrafit 3 të këtij neni, duhet menjëherë, dhe jo më vonë se tre ditë nga marrja e njoftimit, ta njoftojë gjykatën për çdo mosrespektim ose shkelje të masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes.

Neni 13

Profesionisti, gjatë monitorimit të zbatimit të çdo mase tjetër të përkohshme të mbrojtjes, të cilën gjykata e ka shpallur të nevojshme me qëllim sigurinë dhe mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes, e kontakton viktimën lidhur me mënyrën dhe efektet e ekzekutimit të kësaj/këtyre mase/masave.

Pas marrjes së njoftimit nga viktimë për mosrespektimin ose shkeljen e masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes të paragrafit 1 të këtij neni, Qendra duhet menjëherë, dhe jo më vonë se tre ditë nga marrja e njoftimit, ta njoftojë gjykatën.

Neni 14

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon së vlefshmi Rregullorja për Mënyrën e Zbatimit dhe Monitorimit të Masave të Përkohshme të Shqiptuara të Mbrojtjes (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 248/21).

Neni 15

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën pas publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 17-4122/4
23 shtator 2025
Shkup

Ministri i Politikës Sociale,
Demografisë dhe të Rinjve,
Fatmir Limani, d.v.